



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1152 Prot.

Roskovec, më 27, 02 2020

VENDIM

Nr. 13 datë 26/02/2020

PËR

**ANULIM TË VENDIMIT NR.9 DATË 24.01.2020
“PËR NJË NDRYSHIM NË LISTËN E INVENTARIT, MIRATUAR ME VKM NR.770
DATË 24.09.2010 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE QË TRANSFEROHEN NË
PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË ROSKOVEC, TË QARKUT TË
FIERIT”**

*Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.44/2015
“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 113, shkresës Nr.114/1
date 06.02.2020 të Prefektit të Qarkut Fier, Këshilli i Bashkisë,*

VENDOSI:

1. Anulimin e Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.9 datë 24.01.2020 “Për një ndryshim në listën e inventarit, miratuar me VKM Nr.770 datë 24.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Roskovec, të Qarkut të Fierit”. Ky vendim anulohet për mungesë dokumentacioni.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatim të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) dite pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 539 Prot.

Roskovec, më 29.01 2020

VENDIM

NR 9 .DATË 24.01 .2020

“PËR NJË NDRYSHIM NË LISTËN E INVENTARIT, MIRATUAR ME VKM NR. 770, DATË 24.09.2010 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE ,SHTETËRORE QË TRASFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË ROSKOVEC, TË QARKUT TË FIERIT ”

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar neni 54, gërma k) ; Ligjit Nr. 8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar) neni 6, pika 2 , gërma b); Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar) ; ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, neni 2, gërma c, neni 69, pika 5, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, Vkm nr. 770, datë 24.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike ,shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Roskovec, të Qarkut të Fierit”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Ndryshimin në sipërfaqe të pronës me nr.rendor 25,Zk 3196,Roskovec,Parku me Pisha , me sipërfaqe 5000m2 .
- 2- Sipërfaqja do të ndryshohet në 3407 m2.
- 3- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) dite pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

